



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I HISTORISE



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Histori**

**Lënda: HISTORIA E SHQIPËRISË GJATË SUNDIMIT OSMAN PJ. I**

<i>Pedagogu:</i>	Prof. Dr. Ferit Duka
<i>Ngarkesa:</i>	6 ETCS (60 orë: 45 leksione dhe 15 seminare) 3/1
<i>Lloji i lëndës:</i>	e detyrueshme
<i>Viti/Semestri:</i>	II

**Përshkrimi:** Gjatë zhvillimit të kësaj lënde do të trajtohen çështjet kryesore që lidhen me vendosjen e sundimit osman në tokat shqiptare, tiparet e sistemit të ri politik dhe ekonomik, si dhe ndryshimet në jetën shoqërore, kulturore dhe fetare. Në fokus të vështrimit do të jenë gjithashtu përpjekjet e shqiptarëve për çlirim nga sundimi osman, lufta çlirimtare e udhëhequr nga Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe rezultatet e saj, si dhe kryengritjet e zhvilluara gjatë shek. XVI-XIX.

Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet zhvillimeve politiko-shoqërore gjatë periudhës në fjalë, shthurjes së sistemit të timarit dhe lindjes së pronës çifligare, prirjeve të parisë shqiptare të kohës për emancipim politik, rolit dhe rëndësisë së pashallëqeve në jetën politike shqiptare, etj.

Nëpërmjet zhvillimit të këtij kursi do të synohet që studentët të fitojnë njohuri të qëndrueshme në lidhje me aspektet themelore të një segmenti të rëndësishëm të historisë shqiptare të periudhës osmane, si dhe të aftësohen për të analizuar e interpretuar drejt e saktë ngjarjet, dukuritë dhe proceset që zhvillohen në periudhën e dhënë.

**Temat e leksioneve:**

1. Pushtimi osman i tokave shqiptare. Njësitë e para administrative osmane në Shqipëri. Vendosja e sistemit të timarit. Paria shqiptare përballë pushtimit osman.
2. Qëndresa shqiptare nën udhëheqjen e Skënderbeut. Përpjekjet e Skënderbeut për krijimin e një shteti shqiptar të pavarur. Dimensioi kombëtar dhe ndërkombëtar i figurës së Skënderbeut dhe i luftës çlirimtare të shqiptarëve.
3. Zgjerimi dhe konsolidimi i sundimit osman në të gjithë hapësirën shqiptare. Organizimi administrativ osman i tokave shqiptare. Ligji dhe institucionet osmane në Shqipëri. Regjistrimi osman i tokave shqiptare.
4. Tipare të realitetit ekonomiko-shoqëror të tokave shqiptare në periudhën e konsolidimit të sundimit osman (shek. XVI-XVII). Qytetet shqiptare si qendra të zhvillimit ekonomik: zejtaria dhe tregtia. Sistemi esnafor.
5. Vijimi i qëndresës kundërosmane të shqiptarëve: kryengritja e Gjon Kastriotit. Përpjekjet për bashkërendimin e lëvizjes kundërosmane të shqiptarëve me popujt e tjerë të vendeve ballkanike: kuvendet shqiptare dhe ballkanike (fundi i shek. XVI-fill. i shek. XVII).



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË**  
**DEPARTAMENTI I HISTORISE**



6. Ndryshimet në strukturën fetare të popullit shqiptar: përhapja e fesë islame. Tiparet dhe ritmet e procesit të islamizimit. Qyteti shqiptar dhe islamizimi. Sektet islamike: bektashizmi, Kriptokristianizmi. Shkaqet dhe rrjedhojat e procesit të islamizimit.
7. Shenjat e para të krizës së shtetit osman në hapësirën shqiptare: shturja e sistemit të timarit dhe lindja e pronës çifligare. Korruptimi i sistemit fiskal: praktika e iltizimit (sipërmarrjes së taksave). Tipare të zhvillimit ekonomik të viseve shqiptare gjatë shek. XVII-XVIII: bujqësia, zëjtaria dhe tregtia.
8. Konfliktet e shtetit osman me fuqitë perëndimore dhe viset shqiptare. Lufta austro-osmane (1683-1689) dhe kryengritjet shqiptare në Shqipërinë veriore dhe veri-lindore. E ashtquajtura shpërngulje e popullsisë serbe nga territori i Kosovës.
9. Shqipëria osmane e gjysmës së parë të shek. XVIII: fuqizimi i familjeve të mëdha vendase. Ashpërsimi i konflikteve në gjirin e parisë shqiptare: anarki dhe luftë.. Destabilizimi i jetës politike dhe shoqërore në vend.
10. Dobësimi i mëtejshëm i pushtetit qëndror osman në Shqipëri. Dominimi i skenës politike shqiptare nga familjet më të fuqishme. Triumfi i Bushatllinjve të Shkodrës dhe krijimi i pashallëkut me të njëjtin emër. Qeverisja e pashallëkut nga Mehmet pashë Bushati.
11. Fuqizimi i pashallëkut të Shkodrës: Kara Mahmud Pasha qeveritar i pashallëkut. Rënia e pashallëkut të Shkodrës: koha e Mustafa Pashë Bushatit. Likuidimi pashallëkut të Shkodrës dhe rivendosja e autoritetit të pushtetit qëndror osman në Shqipërinë e Veriut.
12. Vitet e para të sundimit të Turqve të Rinj (1908-1912). Tronditje të reja politike dhe shoqërore. Lufta me Italinë. Luftërat ballkanike dhe largimi përfundimtar i perandorisë nga Ballkani.
13. Acarimi i gjendjes politike në Shqipërinë e Jugut: rivaliteti dhe konfliktet midis familjeve të mëdha. Dalja në skenë e Ali Pashë Tepelenës dhe themelimi i Pashallëkut të Janinës. Zgjerimi territorial dhe fuqizimi politik i pashallëkut.
14. Roli i Pashallëkut të Janinës në marrëdhëniet ndërkombëtare të Perandorisë Osmane. Karakteri i qeverisjes së Ali Pashës. Marrëdhëniet e pashallëkut me fuqitë europiane. Acarimi i qëndrimeve të Portës së Lartë ndaj pashait të Janinës. Vrasja e Ali Pashë Tepelenës dhe likuidimi i Pashallëkut të Janinës.
15. Kultura shqiptare gjatë shekujve XVI-XVIII. Arkitektura dhe urbanistika. Letërsia dhe artet. Aspekte të mënyrës së jetesës në viset shqiptare. Roli dhe kontributi i shqiptarëve në kulturën dhe qytetërimin osman.

### **FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT**

**FREKUENTIMI:** 70% pranisë në seminare e domosdoshme.

*15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve*

### **KONTROLLI I VAZHDUESHËM:**

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

*25 % e notës përfundimtare.*

### **DETYRA E KURSIT:**

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times Neë Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

*20 % e notës përfundimtare*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I HISTORISE



**KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:**

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri  
40 % e notës përfundimtare

**Literatura e detyrueshme për studentin:**

1. Bartl, Peter. *Shqiptarët: nga Mesjeta deri në ditët tona*. (Tiranë: IDK, 2008).
2. Duka, Ferit. *Berati në kohën osmane*. (Tiranë: Toena, 2001).

**Literatura plotësuese:**

1. Duka, Ferit. *Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare*. (Tiranë: UET Press, 2009).
2. Frashëri, Kristo. *Skënderbeu. Jeta dhe vepra*. (Tiranë: Toena, 2002).
3. *Historia e Perandorisë Osmane*. bot. Mantran, Robert. (Tiranë: Dituria, 2004).
4. *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. I. (Tiranë: TOENA: 2002).
5. *Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman*, Vëll. I, II. (Tiranë: AIITC, 2009).
6. Inalcik, Halil. *Perandoria Osmane: periudha klasike, 1300-1600*. (Tiranë: Dituria, 2013).
7. Jacques, Edwin. *Shqiptarët*. (Tiranë: KARTË E PENDË, 1995).
8. Schmitt, Oliver Jens. *Arbëria venedike. (1392-1479)* (Tiranë: K&B, 2007).
9. Schmitt, Oliver Jens. *Skënderbeu*. (Tiranë: K&B, 2008).
10. Valentini, Giuseppe. *Statuti personal në Shqipëri në epokën e Skënderbeut*. (Tiranë: Plejad, 2007).